



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Seancat në gjykimin e Hashim Thaçit dhe të bashkakuzuarve rifilluan të hënën, më 22 prill. Më të njëjtën ditë, dëshmitari i 54-të i thirrur nga Prokuroria vazhdoi dhënien e dëshmisë. Dëshmitari dha dëshmi në seancë të mbyllur dhe me masa mbrojtëse.

Dëshmitari i 55-të, Ramiz Qeriqi, filloi dhënien e dëshmisë të hënën. Ai dha dëshmi kryesisht në seancë të hapur dhe përfundoi dëshminë të martën. Sipas përmbledhjes së paraqitur nga Prokuroria, dëshmitari shërbeu si komandant i batalionit të Brigadës 121 të UÇK-së në zonën e Pashtrikut gjatë periudhës që lidhet me aktakuzën. Dëshmitarin e morën në pyetje Prokuroria dhe ekipet e Mbrojtjes.

Pas tij dha dëshmi dëshmitari i 56-të i thirrur nga Prokuroria. Ky ishte dëshmitar i mbrojtur, i cili sipas përmbledhjes së paraqitur në sallën e gjyqit, dha dëshmi lidhur me një person i cili ishte arrestuar nga UÇK-ja më 1999 dhe është i zhdukur që nga ajo kohë. Sot paradite, dëshmitari i 57-të i thirrur nga Prokuroria filloi dhënien e dëshmisë.

Më 23 prill, Trupi Gjykses hodhi poshtë një kërkesë të Mbrojtjes së Selimit për të përfshirë dr. Jasini, aktualisht bashkëmbrojtëse, në komunikimet konfidenciale klient-mbrojtës, por e cila së shpejti do të bëhet konsulente juridike për Mbrojtjen e Selimit. Komunikimet konfidenciale klient-mbrojtës do t'i lejonin dr. Jasinit vazhdim të komunikimeve dhe vizitave të privileguara me z. Selimi.

Trupi Gjykses përsëriti se z. Selimi duket se është përfshirë në nxjerrjen e informacionit konfidencial për palë të treta të paautorizuara dhe konstatoi se kjo, së bashku me atmosferën e ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve në të cilën po kryhet ky gjykim, kërkon qasje veçanërisht të kujdesshme lidhur me privilegjet juridike.

Trupi Gjykses rikujtoi se mbrojtësi dhe bashkëmbrojtësi janë objekt i Kodit të Etikës, përfshirë detyrimin për respektimin e konfidencialitetit dhe se kjo siguron llogaridhënie për kundërvajtje. Anëtarë të tjerë të ekipit të Mbrojtjes, përfshirë konsulentë juridikë nuk mbajnë përgjegjësi drejtpërdrejt sipas Kodit të Etikës.

Trupi Gjykses theksoi se z. Selimi vazhdon të ketë vizita të privileguara me mbrojtës dhe bashkëmbrojtës, dhe se anëtarë të tjerë të ekipit të Mbrojtjes mund të jenë të pranishëm gjatë këtyre vizitave. Z. Selimi i lejohen po ashtu vizita jo të privileguara dhe thirrje telefonike me anëtarë të ekipit të Mbrojtjes, me të vetmin dallim se kërkohet miratim paraprak nga Administratorja. Për këtë arsye, Trupi Gjykses konstatoi se kushtet aktuale përputhen plotësisht me të drejtat e të akuzuarit.

Trupi Gjykses konstatoi gjithashtu se Mbrojtja e Selimit nuk ka arritur të vërtetojë se detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara për dr. Jasinin nuk mund të kryhen brenda kornizës ekzistuese, dhe se synimi i

1





Mbrojtjes për të ndryshuar rolet ndërmjet anëtarëve të ekipit nuk përbën arsye të vlefshme për zgjerimin e privilegjeve juridike.

Gjithashtu më 23 prill, Trupi Gjykues hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Veselit lidhur me lejen për apelim të urdhrit gojor të lëshuar më 25 mars për pranimin e disa dokumenteve si prova. Trupi Gjykues nxori përfundimin se z. Veseli nuk ka arritur të shpjegojë se si vendimi për të pranuar këto dokumente do të ndikonte konsiderueshëm në drejtësi ose rezultat të procesit gjyqësor.

Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është caktuar për të hënë, 29 prill, duke filluar në orën 9:00 paradite.

Më 24 prill, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese hodhi poshtë kërkesën referuese të Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës, duke e konstatuar të papranueshme. Parashtruesit ishin ankuar kundër ndryshimeve në Rregulloren e Ndhmës Juridike të DHSK-së, të miratuar nga Administratorja në shkurt 2024.

Në vendim, Dhoma konstatoi se Kushtetuta dhe Ligji nuk lejojnë persona të kundërshtojnë dispozita në përgjithësi. Nenin 49 i Ligjit lejon vetëm avokatin e popullit ose një trup gjykues t'i parashtrorjë Dhomës pyetje lidhur me kushtetutshmërinë e dispozitave. Personat mund të paraqesin vetëm kërkesa në përputhje me nenin 113 dhe vetëm atëherë kur ka pasur pasoja në të drejtat individuale të tyre.

Gjithashtu, Dhoma theksoi se Rregullorja e Ndhmës Juridike e DHSK-së ofron një mekanizëm për ankesa, të cilët parashtruesit mund ta shfrytëzojnë në qoftë se vendosin të kërkojnë dhe kur të vendosin të kërkojnë ndihmë juridike.

Dhoma konkludoi se në kërkesën referuese nuk ka asgjë që sugjeron shkelje të të drejtave kushtetuese të parashtruesve dhe se duket se parashtruesit ende nuk kanë kërkuar ndihmë juridike, e as nuk është marrë vendim në lidhje me mungesën e mjeteve financiare të tyre.

Më 19 prill, me kërkesë të Mbrojtjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake zgjati afatin brenda të cilit z. Bahtijari duhet të dorëzojë formularët dhe dokumentet mbështetëse për të kërkuar ndihmë juridike nga DHSK-ja. Afati i ri është 29 prilli. Gjykatësi konstatoi se janë paraqitur arsye të vlefshme, sepse që nga parashtrimet e fundit, Mbrojtja ka përparuar me përgatitjen e kërkesës.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

